



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.11/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), Danush Ademi nga Ferizaj, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të tërheqjes nga lista të anëtarëve për Asamble Komunale në Komunën e Ferizajit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës 2017, jashtë seancës së panelit të mbajtur me datë 12.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

KONSIDEROHET si e tërhequr ankesa Anr.11/2017 e datës 06.09.2017, e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), Danush Ademi nga Ferizaj.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 06.09.2017 nga subjekti politik PDAK me të cilën ankesë pretendon se subjekti politik PDAK me datë 05.09.2017 është njoftuar nga KQZ-ja se tre kandidatët nga radhët e subjektit politik PDAK duhet të tërhiqen nga lista dhe të zëvendësohen, sepse kanë aktgjykime të plotfuqishme. Për më tepër thekson se, disa nga kandidatët përfshirë kandidatin për kryetar të komunës së Ferizajit nga radhët e subjektit politik Partia e Ashkalive për Integrim (PAI), janë në listën e kandidatëve për Zgjedhjet Lokale dhe të njëjtit kandidatë kanë lëndë të hapura në gjykatë dhe po ashtu janë të dënuar sipas vendimit gjyqësor, prandaj PZAP-it i ka kërkuar që të verifikoj kandidatët nga radhët e subjektit politik PAI.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 3 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it (Rregullës nr.02/2015), sipas shkresës me numër protokoll 11/2 - Ref. No.ZKS/PZAP-i e datës 06.09.2017, kërkoi nga parashtruesi i ankesës për ta plotësuar ankesën ZL.Anr.11/2017 të datës 06.09.2017, gjegjësisht që ta specifikoj saktësisht numrin e vendimit të KQZ-së të cilin e ankimon, të bëjë identifikimin e kandidatëve të subjektit politik PDAK të larguar nga KQZ-ja nga lista e kandidatëve, si dhe të ofroj dëshmi për emërat e kandidatëve nga radhët e subjektit politik PAI dhe provat për të cilët pretendoni se të njëjtit kandidatë kanë lëndë të hapura në gjykatë dhe janë të dënuar.


Paneli pasi që shqyrtoj shkresat e lëndës konstatoj, se ankesa e tillë konsiderohet se është TËRHEQUR, për këto arsye:

Paneli, vërtetohet se edhe përkundër kërkesës së bërë ndaj parashtruesit të ankesës lidhur me plotësimin e ankesës ashtu siç parashihet shprehimisht sipas dispozitës së nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, “Ankesa e cila nuk i plotëson kriteret e parapara sipas nenit 5.7 të këtyre rregullave, i kthehet palës ankuese në përmirësim dhe plotësim në afat prej njëzetekatër (24) orëve. Do të konsiderohet si e tërhequr ankesa po që se nuk i kthehet PZAP-it brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet e pa korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, ankesa do të hidhet poshtë”. Paneli nuk e ka pranuar plotësimin e ankesës, pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të cekura në kërkesën për plotësim në ankesë me numër protokollit 11/2 - Ref. No.ZKS/PZAP-i e datës 06.09.2017.

Prandaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, bazuar të nenin 6 pika 3 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Rregullës nr.02/2015), lidhur me nenin 118 paragrafi 1, i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr.03/L073), Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.11/2017 me datën 12.09.2017

Kryesuesi i Panelit
Dr.sc. Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.